



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Ligji Nr. 05/L -152

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR NË MES TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA  
FEDERALE E FINANCIVE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR NË MES TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, E PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA  
FEDERALE E FINANCIVE**

**Neni 1**  
**Qëllimi i ligjit**

Ky Ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

**Neni 2**  
**Ratifikimi i Marrëveshjes**

Ratifikohet Marrëveshja për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

**Neni 3**  
**Dokumentet e bashkëngjitura**

Në Shtojcën e këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për Bashkëpunim Financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -152**  
**10 mars 2017**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Kadri VESELI**

**MARRËVESHJA**

**NDËRMJET**

**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I FINANCEVE**

**DHE**

**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË  
AUSTRIË**

**PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI FEDARAL I FINANCEVE**

**PËR**

**BASHKËPUNIM FINANCIAR**

Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Qeveria e Republikës së Austrisë përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave, më poshtë të quajtura “ Palët Kontraktuese”,

*Duke dëshiruar* të promovojnë më tutje marrëdhëniet e afërta dhe miqësore që ekzistojnë në mes dy shteteve,

*Duke dëshiruar* të zhvillojnë, zgjerojnë dhe thellojnë bashkëpunimin e tyre financiar,

kanë arritur mirëkuptimin e përbashkët të mëposhtëm:

### **Neni 1- Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të ofroj një kornizë për zbatimin e projekteve zhvillimore dhe bashkëpunimin financiar në mes Palëve Kontraktuese brenda ligjeve të tyre përkatëse ekzistuese, rregulloreve dhe politikave si dhe obligimeve të tyre ndërkombëtare.

### **Neni 2 – Kreditë Koncesionare**

Me qëllim të promovimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit financiar, Ministri Federal Austriak i Financave është i gatshëm të mbështes dhënien e kredive ndihmëse me kushte lehtësuese, të ri-financuara nga Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft (OeKB), Vienna, sipas skemës së financimit eksportues të saj për projektet e interesit të ndërsjellë në Republikën e Kosovës.

Një kornizë financiare treguese prej EUR 30,000,000 (tridhjetë milion euro) duke përfshirë pjesën e pashfrytëzuar të 15.000.000 EUR (pesëmbëdhjetë milion Euro) që nga 31 Gushti 2016 të Marrëveshjes që skadon në fund të vitit 2016 parashikohet për periudhën e vlefshmërisë prej dy vitesh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje

### **Neni 3 – Kushtet për Kreditë Koncesionare**

Financimi koncesional austriak kryesisht ofrohet si financim ndihmës në formë të kredive të parapërziera që i nënshtrohet një kërkesë koncesionale minimale prej së paku 35%.

Kushtet dhe afatet e kredive do të vendosen në pajtim me obligimet ndërkombëtare në veçanti “Marrëveshja për kreditë eksportuese të mbështetura zyrtarisht” sipas kushteve të favorshme të OECD-së (OBZHE).

Kushtet dhe afatet e ofruara së fundmi sipas skemës së kredive të buta austriake janë të publikuara në [www.oekb.at](http://www.oekb.at) dhe të bashkëngjitura si Shtojca 1 për qëllime informuese të pastra.

#### **Neni 4 – Pranueshmëria e Projekteve**

Pranueshmëria e projekteve që do të financohen do të vlerësohet duke marrë parasysh udhëzimin ex-ante të fituar sipas disiplinave ndihmëse të "Helsinkut", si dhe kritereve kombëtare të aplikueshme të shpërndarjes.

Një listë indikative e sektorëve të privilegjuar për projekte është e bashkëngjitur si Shtojca 2.

#### **Neni 5 – Prokurimi**

Llojet e prokurimit të mëposhtme për projektet që do të financohen sipas skemës së kredive të buta Austriake:

- a. Ofertë e kufizuar (e kufizuar për kompanitë e pranueshme sipas skemës së kredive të buta Austriake)
- b. Kontraktimi i drejtpërdrejtë

#### **Neni 6 – Subjektet për Kreditë**

Marrëveshjet për kredi të rifinancuara nga OeKB negocohen dhe arrihen drejtpërdrejtë në mes bankave komerciale si huadhënëse dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës si huamarrëse.

#### **Neni 7 – Përfshirja e Projekteve**

Përfshirja e projekteve në këtë marrëveshje do të arrihet përmes shkëmbimit të letrave në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë Federale të Financave së Republikës së Austrisë dhe pas hyrjes në fuqi të ofertës dhe kontratës financiare.

#### **Neni 8 – Përdorimi i Kredive**

Kreditë ndihmëse të dhëna do të shfrytëzohen për blerjen e pajisjeve dhe shërbimeve Austriake për projektet zhvillimore në Republikën e Kosovës, të cilat mund të përfshijnë deri në 50% të pajisjeve dhe shërbimeve kapitale me prejardhje jashtë Austrisë.

#### **Neni 9 – Garantimi**

Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, do të garantoj në mënyrë të parevokueshme dhe pa-kushtëzime përmbushjen e të gjitha pagesave që dalin nga kreditë koncesionare Austriake.

## **Neni 10 – Tatimet**

Të gjitha pagesat nga huamarrësi sipas kredive koncesionare të mbështetura zyrtarisht sipas sistemit financiar eksportues Austriak do të jenë të lira nga çfarëdo forme e tatimit, nëse ekziston, apo zbritjeje çfarëdo qoftë ajo.

## **Neni 11- Rishikimi i Progresit**

Palët Kontraktuese do të bëjnë në baza vjetore, ose kurdo që vlerësohet e nevojshme, rishikimin e progresit sipas kësaj Marrëveshjeje.

## **Neni 12 – Vlerësimi për Përdorimin e Kredive**

Në mënyrë që të vlerësohet përdorimi i kredive të dhëna koncesionare sipas kësaj Marrëveshjeje dhe qëndrueshmëria e projekteve përkatëse, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës do të ndihmoj duke siguruar e gjithë dokumentacionit e nevojshëm për vlerësim, auditim dhe mbikëqyrje të projekteve.

## **Neni 13- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në mes Palëve Kontraktuese që ka të bëjë me interpretimin dhe /ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet kanaleve diplomatike.

## **Neni 14 – Hyrja në Fuqi dhe Vlefshmëria**

Marrëveshja e tanishme do të hyj në fuqi në ditën e parë të muajit pas muajit në të cilin Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëri tjetrin për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme në shtetet e tyre përkatëse. Mund të ndryshohet apo vazhdoj për periudha të ngjashme me pajtimin reciprok të Palëve Kontraktuese. Mund të rinovohet automatikisht për një periudhë prej dy vitesh përveç nëse refuzohet ndërkohë në të shkruar nga cila do Palë Kontraktuese pas një njoftimi paraprak gjashtëmuor.

E bërë në dy origjinale, të dyja në gjuhën Angleze.

Për Qeverinë e Republikës  
së Kosovës

përfaqësuar nga  
Ministri i Financave

Avdullah Hoti

Vendi/Data

Për Qeverinë e Republikës  
së Austrisë

përfaqësuar nga  
Ministri Federal i Financave

Hans Jorg  
Schelling

Vendi/Data

## **SHTOJCA 1**

Kushtet dhe afatet treguese sipas 15 janarit 2016 përfshijnë një periudhë shlyerje prej pesëmbëdhjetë e gjysmë (15,5) vjeç, e cila përfshin një periudhë katër (4) vitesh mospagimi, një normë interesi zero (0) për qind në vit, si dhe reduktimin e tarifave të garancisë dhe kostot e tjera të financimit.

Këto janë mund të ndryshojnë për shkak të rivendosjes vjetore të normës së skontimit nën kujdesin e OECD, dhe mund të akoma me shumë të ndryshojnë për shkak të klasifikimit të rrezikut të vendit të OECD-së

## **SHTOJCA 2**

Projektet e pranuar me Kredi të Buta në sektorët më të favorshëm, në mes të tjerash:

- Fusha e Bujqësisë (p.sh. sistemi i ujitjes)
- Sektori i ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza
- Shëndetësia
- Sektori i trajtimit të mbeturinave
- Arsimi dhe trajnimi profesional
- Fusha e infrastrukturës (p.sh. hekurudha, ura, sinjalizim)
- Mbrojtja civile (p.sh. zjarre fikja, paralajmërim emergjencash)
- Zgjidhjet e E-qeverisjes